



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 378 prot.

Tiranë, më 18.10 2019

V E N D I M

Nr. 22 datë 18.10.2019

Asambleja e Akademisë së Shkencave e Shqipërisë, e mbledhur më datë 18 tetor 2019, ora 11.00, me thirrjen e Kryesisë sipas vendimit nr. 21, datë. 10.10.2019, me rend dite:

1. Miratimin e Statutit të ri të ASH, në zbatim të ligjit nr.53/2019, neni 7, pika 6.
2. Shqyrtimin e Dekretit të Presidentit të Republikës nr.11223, datë 11.07.2019, dhe emërimin e Kryetarit të ASH-së, sipas ligjit nr.53/2019, neni 11, pika 6, 7.
3. Shpalljen e hapjes së vendeve të reja për anëtarë të Asamblesë me titullin “Akademik” dhe “Akademik i asociuar”.

Në prezencën e 28 anëtarëve të Asamblesë (numër i mjaftueshëm për të siguruar kuorumin e mbledhjes), dhe me pjesëmarrjen në distancë të 11 Akademikëve, pasi miratoi rendin e ditës me 1 (një) votë kundër

V e n d o s i :

1. Të miratojë statutin e ASH-së me 38 vota “pro” dhe 1 (një) kundër, me një saktësim për nenin 35 të statutit, të propozuar gjatë mbledhjes sipas procesverbalit.
2. Me 2 vota “pro”, 1 abstenim dhe 36 kundër të mos mbështesë Dekretin nr.11223, datë 11.07.2019 të Presidentit të Republikës, bazuar në pikën 6, neni 11 të ligjit 53/2019 dhe statutit neni 19, pika 2. (Për të mbështetur Dekretin duheshin të paktën 23 vota “pro”).
3. Të shpallë të emëruar me 36 vota “pro”, Kryetarin e zgjedhur të ASH-së, në bazë të nenit 11, pika 7, të ligjit 53/2019 dhe të nenit 19, pika 3 të Statutit të ASH. Kryetari i Akademisë së Shkencave fillon detyrën më datë 21 tetor 2019.
4. Të shpallë në parim hapjen e 8-10 vendeve të reja për anëtarë të Asamblesë, duke filluar procedurat për përcaktimin e fushave përkatëse sipas nenit 7 të statutit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI

VASIL S. TOLE



1 | F a q e